



## PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit e mbajtur me datë **26.04.2019** me fillim në ora **10.15**, këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete mbledhjes z. Bajram Morina. **Kryesuesi** – Përhëndes përfaqësuesit e OSBE-së, UNMIK- ut, SHL- Kosova, juve anëtarë të Komitetit për Komunitet dhe të gjithë të pranishmit. Konstatoj se kemi kuorum për mbajtjen e mbledhjes.

### REND DITE

1. **Aprovimi i procesverballi të mbledhjes së kaluar,**
2. **Gjendja e nxënësve të komuniteteve në shkollat e komunës sonë,**
3. **Raporti i punës tre mujore i Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete,**
4. **Të ndryshme.**

E qes në aprovim rendin e ditës, konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

#### 1. **Aprovimi i procesverballit të mbledhjes së kaluar.**

Ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverballit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në votim procesverballin: Konstatojmë se pika e parë e rendit të ditës është aprovuar, kalojmë në pikën e radhës:

#### 2. **Gjendja e nxënësve të komuniteteve në shkollat e komunës sonë.**

**Kryesuesi** - Ne zyrtarisht i kemi ftuar që të marrin pjesë në këtë mbledhje zyrtarët e DKA-së, por siç jeni duke parë deri në këtë moment nuk kanë ardhur. Para vete e keni një raport nga DKA-ja sa i përket numrit të nxënësve të komunitetit RAE në shkollat e komunës sonë, fjala është e juaja nëse keni diçka të shtoni sa i përket këtij raporti.

**Ali Zhuniqi** – Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar pika e dytë e rendit të ditës titullohet: Gjendja e nxënësve të komuniteteve në shkollat e komunës sonë, kurse dokumenti i cili neve na ka ardhur nga DKA-ja titullohet: Raporti i DKA-së për numrin e nxënësve të komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptas, në shkollat e komunës sonë, pra këtu kemi të bëjmë me një statistikë, ky raport nuk ka përputhshmëri me pikën e dytë të rendit të ditës.

**Kryesuesi** – I nderuar z. Ali Zhuniqi ne nga DKA-ja më herët ju kemi kërkuar statistikën e nxënësve të Komunitetit RAE, qëllimi ka qenë që ne të jemi të informuar se sa kanë qenë numri i nxënësve që e kanë braktisur shkollën. Dhe sipas kësaj DKA-ja na ka sjellë saktësisht një statistikë e cila tregon qartë se sa nxënës vijnë në shkollë dhe sa nxënës e kanë braktisur atë.

**Ali Zhuniqi** – I nderuar kryesues ne i besojmë këtij raporti, por unë e ceka se ky raport bie në kundërshtim me pikën e rendit të ditës. Ne edhe në mbledhjet e kaluara kemi kërkuar që anëtarët e atij komisioni që është formuar po nga ky komitet të dalim ne teren, dhe të shohim se si është gjendja e nxënësve të këtyre komuniteteve. Pra të shohim se me çfarë probleme janë duke u ballafaquara ata, pastaj cilat janë kërkesat e tyre etj.

**Skender Hamza**, Udhëheqës i Sektorit për Kuvend - Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuar z. Ali Zhuniqi, vërejtje juaj është me vend, mendoj se formulimi i pikës të rendit të ditës nuk është formuluar ashtu si është dashtë, mendoj se formulimi është dashur të bëhet ashtu sikurse që është në raportin e DKA-së.

**Mirjeta Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket kësaj pike desha të shtoj diçka konkrete, në shkollën fillore “ 4 Dëshmorët” ku unë punoj, kemi një nxënëse nga komuniteti pakicë e cila është riatdheluar, por pasi që nuk ka pasur dokumente përkatëse për të dëshmuar që ka vijuar ndonjë vit në shkollë në Gjermani, e njëjta është futur në klasën e tretë. Moshë e saj është rreth 14 vjeçe, pra shokët e gjeneratës së saj janë diku në klasë të 8 ose 9. Kërkoj që të mëren masa konkrete dhe kjo nxënëse të mos mbetet në këtë klasë, pra mos ta neglizhojmë sepse nëse e lëmë aty atëherë ajo do të dele nga shkolla fillore në moshën 20 vjeçare.

**Kryesuesi** – Ju faleminderit për diskutimin e zhvilluar në pikën e dytë, kalojmë në pikën e tretë:

### **3. Raporti i punës tre mujore i Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete.**

**Lendrit Çeli**, Shef i zyrës për Kthim dhe komunitete – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do ju raportoj për përdhën janar – mars 2019, besoj se secili nga ju e keni pas para vete edhe raportin në mënyrë fizike, shpresoj të keni pasur kohë për të shfletuar. Nëse dëshironi unë mundem të ju lexojë raportin, por mendoj se më mirë kishte me qenë nëse ka dikush ndonjë pyetje sa i përket raportit, pastaj unë do ju japë përgjigje.

**Darko Antiq** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket raportit të zyrës komunale për kthim dhe pikës të cilën jemi duke e diskutuar, desha të ju informojë se ndriçimi publik nuk është plotësisht funksional dhe ka shumë defekte në lagjen e epërme të Rahovecit.

**Lendrit Qeli** – Po i nderuar jam i informuar se gjendja e ndriçimit publik nuk është në gjendje shumë të mirë, ne si zyre në bashkëpunim me organizatën IOM, do të shohim se çka mundemi të bëjmë me tre zona që ne i kemi përcaktuar, si Hoça e Madhe, pjesa e epërme e qytetit të Rahovecit dhe do të shohim mundësin që ta përfshimë edhe Krushën e Madhe, besoj se brenda disa ditëve nuk do të ketë më këso probleme.

**Afërdita Thaqi** – Desha një informatë shtesë për këto familje me nevoja sociale të cilat kanë nevojë për shtëpi, desha ta di a kemi qasje ne në këtë projekt, dhe a ka mundësi të na japësh informata shtesë.

**Lendrit Qeli** – Zyra komunale për Komunitete dhe Kthim ka pranuar disa kërkesa, por meqenëse ne e dimë se si është gjendja e komuniteteve në fjalë, ne si zyre shumë shpejtë me donatorët potencial kemi kërkuar që të bëhet komplet një analizë e gjendjes e të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunën e Rahovecit. Kemi disa sinjale nga disa donatorë nga Zvicra, të cilët janë interesuar që të jenë pjesë e realizimit të këtij projekti nëse mundem të them, po ashtu ne kemi pasur një takim në Kamenicë me organizatën Voice of Romë Ashkali end Egyptian. Kjo organizatë e ka një buxhet për renovimin dhe ndërtimin e shtëpive, po ashtu pritet që edhe ne si zyre të participojmë me një pjesë të shumës, janë diku rreth 20-25 shtëpi potenciale që munden të ndërtohen përmes mjeteve që i kanë ata. Momentalisht i kemi këto që i kemi cekur në raport, ku kemi kërkuar nga niveli qendrorë mbështetje si në Ministrin për Komunitete dhe Kthim dhe në Ministrin për Punë dhe Mirëqenie Sociale, në këto ministri ne kemi dy zëvendësministra nga radhët e komuniteteve, ne çdo ditë jemi kontakt me ta dhe jemi duke i bërë presion me kërkesat tona. Pas takimeve të shumta që i kemi pasur ata na kanë dhënë një sinjal që dy nga këto shtëpi do të rinovohen, përndryshe qasje mundeni të keni, nëse keni dëshirë mundemi të shkojmë së bashku edhe në teren për ti vizituar këto familje. Po ashtu një shtëpi do të ndërtohet nga themelet në fshatin Ratkoc nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

**Mirjeta Krasniqi** – Desha të kërkoj informata shtesë në lidhje me 8 aplikacionet për mbështetje të bizneseve Start Ap, a do të kemi qasje ne si Komitet për Komunitete për këto dy projekte që do të përzgjidhen, pra a do të ketë transparencë.

**Lendrit Qeli** – E nderuar IOM është organizatë e cila në kuadër të programit të sajë që dy biznese Start Ap ose zgjerim të bizneseve për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë do të mbështeten, fatkeqësisht para dy dite ne kemi pasur një bisedë jo të këndshëm me njëri tjetrin, për arsye se përzgjedhja nuk është bërë ashtu siç është dashur të bëhet. Përzgjedhja është bërë me direktiva të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, ku janë përzgjedhur dy përfitues të mundshëm që në këtë rast janë nga komuniteti serb të fshatit Hoçë e Madhe. Ne si zyre kemi kërkuar një transparencë më të

mirë në këtë drejtim dhe një bashkëpunim më të duhur, sepse besoj se ne mundemi të i dimë më mirë se ata gjendjen e komuniteteve që jetojnë në komunën tonë, sepse ne jemi vazhdimisht në teren dhe vazhdimisht na vinë kërkesat nga ta. Ka pasur aplikime nga të gjitha komunitetet dhe nuk është në rregull të bëhet një geotizim ndaj një komunitet karshi komuniteteve tjerë, që fatkeqësisht konsiderohen edhe si komunitete të marginalizuar siç është komuniteti Romë, Egjiptas dhe Ashkali. Ne kemi marrë një premtim se në të ardhmen më nuk do të ndodhë kështu përzgjedhja, por për arsye se kanë qenë mjetet e ministrisë të dedikuara për IOM-in kanë shkuar në këtë version.

**Ali Zhuniqi** – Tek identifikimi i projekteve që kanë të bëjnë me gjendjen e infrastrukturës, nuk e di a ju kanë adresuar juve, por mua më janë adresuar një 3 familje në nga fshati Fortesë, për shkak të ndryshimit të rrjedhës së lumit në fshatin Fortesë një pjesë e lumit kalon pranë shtëpive të tyre dhe i bashkëngjitet një rrjedhe tjetër të lumit. Kërkesa e tyre ka qenë që të ndërmerret diçka sa i përket këtij problemi sepse ka edhe derdhje të ujërave të zeza, ku gjatë stinës së verës ka një kundërmim të erës dhe kjo është e papërbalueshme për këta banorë. Kërkoj nga ju që të ndërmerreni hapa për sanim të këtij problemi. Pastaj tek pika që e keni cekur se nga muaji mars me qëllim të integritetit të mirë të zyrtarëve nga zyra e vendit të fshatit Hoçë e Madhe, punëtorët e kësaj zyre dy herë në javë janë transferuar me punë në objektin e komunës së Rahovecit, kisha pas dëshirë ma shpjegoni pak këtë se nuk e kam shumë të qartë.

**Lendrit Qeli** – Sa i përket pyetjes për infrastrukturën të disa shtëpive ku jetojnë komuniteti jo shumicë në fshatin Fortesë, neve nuk na ka ardhur asnjë informatë rreth këtij problemi, për kundër faktit që ne e kemi vizituar vetëm fshatin Xërxë, Senoc dhe Krushë e Madhe, sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me infrastrukturë, ditëve në vazhdim patjetër që do ta vizitojmë edhe fshatin Fortesë. Ne së bashku me Drejtorin e Shërbimeve Publike do të shikojmë mundësinë për mbështetje sepse ne si zyre e kemi një fond të limituar sa i përket këtij drejtimi. Kurse sa i përket pyetjes së dytë, në kuadër të domenit të zyrës sonë figurojnë 8 punëtor, një pjesë e stafit është e vendosur në ndërtesën e komunës në Rahovec, kurse pjesa tjetër janë të pozicionuar në fshatin Hoçë e Madhe. Ne nuk kemi ndonjë mekanizëm që të na vërtetoj se a dalin në punë çdo ditë punëtorët, pastaj a kryhet puna si duhet, kemi marrë një vendim që dy herë në javë të vinë në objektin e komunës në Rahovec. Me këtë edhe do të integrohem ta quajmë me pjesën e poshtme të qytetit, ky ka qenë qëllimi ynë kryesor, i cili është realizuar me sukses.

**Afërdita Thaqi** – E kam një kërkesë sa i përket një familje në fshatin Çifllak, emrin e kryefamiljarit për momentin nuk ja di, ata e kanë shtëpinë shumë të dëmtuar, ata jetojnë lirishtë mundmi të themi sikurse në një stallë, ju kisha lutë që të shkoni të ja bëni një vizitë kësaj familje dhe të shikoni se çka mundeni të bëni për këtë familje.

**Lendrit Qeli** – Fatkeqësisht Zyra për Komunitete dhe Kthim qëndron dobët financiarisht, siç e thash e kemi një buxhet të vogël, ne i kemi vetëm 10,000.00 € buxhet për investime kapitale, dhe me këtë buxhet ne nuk mundemi të bëjmë shumë. Por e mira e kësaj zyre është se ka filluar të krijojë partnerë me organizata ndërkombëtare dhe OJQ lokale, janë ndihmuar 4 familje nga një organizatë e komunitetit egjiptian e cila vepron në Gjermani, po ashtu gjatë muajit Ramazan do të ndihmohen rreth 28 familje, shpresoj se përmes kësaj organizate do të gjejmë mundësi që ti dalim në ndihmë edhe familjes në fjalë.

**Ramë Berisha** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket infrastrukturës ne si anëtar të komuniteteve i kemi bërë disa kërkesa sa i përket nevojave të komunitetit të cilat i përkasim, ka pas kërkesa për ndriçim, pastaj për rregullimin e një rruge në fshatin Xërxë. Para sa dite zyrtarët e komunës kanë qenë në teren për rregullimin e kësaj rruge, shpresoj se shumë shpejtë do të futet në projekt për rregullim kjo rrugë, sepse është shumë e nevojshme për banorët e kësaj lagje.

**Lendrit Qeli** – Ne si zyre menjëherë pas kërkesës nga ana e juaj kemi dalë në teren së bashku me zyrtarët e Drejtorisë për Shërbime Publike, ku e kemi analizuar gjendjen, ku sipas inxhinierëve të kësaj drejtorie kjo rrugë e kapë një kosto prej 5,000.00 €, ne jemi duke diskutuar me IOM-in që 50% e shumës të jetë nga ta dhe 50% nga komuna.

**Bajram Morina** – Ju faleminderit për debatin e zhvilluar, kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

#### 4. Të ndryshme.

**Darko Antiq** – Është një problem i cili është paraqitur në lagjen e epërme të qytetit të Rahovecit, një vrimë e madhe është hapur në kanalën e lumit Dullo, gjatë sezonit të verës krijohet një problem sepse lumi nuk rrjedh, pastaj njerëzit janë duke e keqpërdorur atë pjesë ku i hedhin mbeturinat. Por në momentin që vije uji këto mbeturina krijojnë probleme, prandaj e kam një kërkesë për Drejtorin e Shërbimeve Publike që të merren masa që kjo gropë të mbyllet.

**Lendrit Qeli** – Ne do ja përcjellim këtë shqetësim drejtorisë përkatëse, por po ju lajmëroj se shumë shpejtë do të rregullohet çështja e mbeturinave sepse do ju sjellin kontejnerë të rinj dhe besoj me këtë do të eliminohet dhe kjo si dukuri.

**Kryesuesi** - A ka dikush të shtoj edhe diçka tjetër sa i përket kësaj pike, nëse jo ju faleminderit për të gjithëve për kontributin e dhënë sot, me kaq mbledhja ka përfunduar shihemi në takimet e radhës.

Mbledhje ka përfunduar në ora 11:00

Procesmbajtësi,

  
Skender Hamza

